

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Nushe Kadrija, në çështjen penale kundër të akuzuarit N. O. nga fsh. N. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armëve nga 374/1 te KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/II.nr.1815 /17 të datës 27.02.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **10.08.2017**, në prani të Prokurorit te shtetit Ramiz Buzhala dhe te akuzuarit N. O., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari **N. O.**, i biri i A. dhe i nënës Xh. e gjinisë Z., dat e lindjes.., në Gjakovë, tani banon ne fsh. N. K Gjakovë, ka te kryer shkollën e mesme, punëtor , i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës,i pa martuar, me nr. ID....

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

- me pare ka siguruar e gjere me dt. 07.11.2016, rreth orës 22.20min, pa autorizim , ka poseduar armë dhe municion në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla dhe atë një armë revole-të markës “TT”,pa numër serik, me karikator dhe 7 (shtatë)copë fishekë te kalibrit 7.62mm., në atë mënyrë që natën kritike zyrtaret policor duke patrulluar ne rrugën magjistrale Pejë-Prishtinë, pikërisht ne fsh. Gllarevë, të pandehurin e kanë urdhëruar te dal jashtë veturës për kontroll, i njëjti menjëherë ka mbyllur derën e automjetit dhe me shpejtësi ka ikur ne drejtim te Prishtinës, mirëpo pas dy orësh është paraqitur ne st. policor ne Klinë i cili ka njoftuar se tek shtëpia e tij posedon një revole ,me pas se bashku me zyrtaret policor ka shkuar për ta marr dhe sekuestruar armen dhe municionin e lartcekur.

-me çka ka kryer vepër penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par. 1 te KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,43,46,73 dhe nenit 374/1 të KPRK-ës, dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarit N. O., i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Ne shumen prej 800,00-€ (tetëqindën euro), te cilin dënim është i detyruar ta paguaj ne 2(dy) këste ne afatin prej 2 (dy) muajve nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit dhe atë kësti i pare ne shume prej 400 (katërqind) euro do te paguhet deri me datën 5 te muajit te pare pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, kësti i dyte prej 400 (katërqind) euro do te paguhet deri me datën 5 te muajit te dytë, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit .

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 40 (katër dhjetë) ditësh duke ia llogaritur 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi .

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë ne emër te paushallit gjyqësorë shumën prej **30,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Konfiskohet revolja e markës “TT” pa numër serik, me karikator nga 7(shtatë) copë fishekë te kalibrit 7.62mm., si objekt i kryerjes se veprës penale dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të shkatërrohen .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.18185/16 të dt.27.02.2017, e ka akuzuar të akuzuarin N. O. nga fsh. N. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi, kontrolli ose posedimi te paautorizuar te armeve nga 374/1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala , pas leximit te aktakuzës dhe pasi i akuzuari ka pranuar fajësinë ka theksuar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit .

I akuzuari N. O., gjate shqyrtimit fillestar duke u deklarua lidhur me fajësinë theksoi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryera me arsytim se të njëjtën nuk e kam keqpërdorë asnjëherë , dhe se nuk e kam ditur që nuk lejohet të mbajë armë se në të kundërtën nuk do ta kisha mbajtur. I propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës, pendimin e shprehur për veprën e kryer si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, të më shqiptojë një dënim më të butë.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari N. O. : me pare ka siguruar e gjere me dt. 07.11.2016, rreth orës 22.20min, pa autorizim , ka poseduar armë dhe municion në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla dhe atë një armë revole- të markës “TT”,pa numër serik, me karikator dhe 7 (shtatë) copë fishekë te kalibrit 7.62mm., në atë mënyrë që natën kritike zyrtaret policor duke patrulluar ne rrugën magjistrale Pejë-Prishtinë, pikërisht ne fsh. Gllarevë, të pandehurin e kanë urdhëruar te dal jashtë veturës për kontroll, i njëjti menjëherë ka mbyllur derën e automjetit dhe me shpejtësi ka ikur ne drejtim te Prishtinës, mirëpo pas dy orësh është paraqitur ne st. policor ne Klinë i cili ka njoftuar se tek shtëpia e tij posedon një revole ,me pas se bashku me zyrtaret policor ka shkuar për ta marr dhe sekuestruar armen dhe municionin e lartcekur.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimi te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjesisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit ,pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij , sjelljen korrekte në gjykim , premtimin se një veprim i tillë nuk do te përsëritet si dhe faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata te akuzuarit N. O. i shqiptojë dënimin me gjobë ne shumën prej 800,00 -€(tetëqind euro), me bindjen e plote se ky dënim është ne harmoni me peshën e veprës penale ,shkallen e përgjegjesisë se te akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj te akuzuarit do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 te KPRK-ës .

Vendimi për konfiskimin e revoles e markës “TT” pa numër serik, me karikator nga 7(shtatë)copë fishekë te kalibrit 7.62mm., është marr bazuar ne nenin 374/3 te KPRK-ës .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.165/17 më datë 10.08.2017.**

**Sekretarja juridike,
Nushe Kadrija**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** , nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.